

Shoqata Gjermane e Industrisë dhe Tregtisë në Shqipëri
Rr. Skëndërbej 4/7
Tiranë, Shqipëri
Tel : +355 (0)4 2227146
Email : info@diha.al



Tiranë, më 22.07.2024

Lënda: Kthim përgjigje ftesës për bashkëpunim.

Z. FATMIR XHAFAJ
KRYETAR I KOMISIONIT TE POSAÇËM PARLEMANTAR

I nderuar z. Xhafaj,

Duke Ju falënderuar për ftesën Tuaj dhe duke Ju uruar suksese në punën Tuaj si Kryetar i Komisionit të Posaçëm Parlamentar dua t'iu njoftoj se DIHA ka si një ndër qëllimet kryesore të saj mbështetjen e kompanive gjermane dhe shqiptare, forcimin e marrëdhënieve ekonomike dhe rritjen e volumit tregtar. Një parakusht thelbësor për këtë, është përmirësimi i klimës së biznesit në Shqipëri, në të cilën veprimtaria e komisionit Tuaj mund të japë një kontribut me vlerë. Për këtë arsye, ne do të donim të kufizoheshim në këtë deklaratë të shkurtër me shkrim.

Ne jemi besimplotë për potencialin që vendi ofron për biznes dhe për investime të huaja, për shkak të vendndodhjes strategjike, burimeve natyrore dhe fuqisë punëtore të kualifikuar. Megjithatë, anëtarët tanë vijnë të identifikojnë pikat e mëposhtme si sfida kryesore për kompanitë në Shqipëri: a) Parashikueshmëria e politikave ekonomike, b) Lufta kundër kriminalitetit dhe korrupsionit, c) Transparenca e tenderëve publikë. Nga këndvështrimi ynë këto janë tre sfidat kryesore të sipërmartjes në Shqipëri dhe në të njëjtën kohë fushat me më shumë nevojë për përmirësim të konsiderueshëm.

Nisur nga statusi i Shqipërisë si vend kandidat për anëtarësim në BE, ne e konsiderojmë të rëndësishme të punohet në kuadër të veprimtarisë së Komisionit të Posaçëm në fushat e mëposhtme:

1. Miratimi i një Strategjie Investimi, të udhëhequr nga nivelet më të larta të Qeverisë, duke përfshirë reduktimin e ndjeshëm të pengesave burokratike, miratimin e një sistemi të bazuar në rregulla për lëshimin e lejeve dhe ngritjen e një sistemi nxitës incentivash të bazuar mbi shumën e investimeve dhe krijimin e vendeve të reja të punës.
2. Zbatimi i një pakete me qëllim luftën Kundër-Korrupsionit që forcon përputhshmërinë e masave kundër korrupsionit me standardet e OECD-së dhe që siguron transparencë në veprimtarinë e agjencive publike. Kjo do të rriste ndjeshëm besimin e komunitetit të biznesit në përgjithësi dhe veçanërisht të kompanive të huaja që investojnë në Shqipëri.

Shoqata Gjermane e Industrisë dhe Tregtisë në Shqipëri
Rr. Skënderbej 4/7
Tiranë, Shqipëri
Tel : +355 (0)4 2227146
Email : info@diha.al



3. Rritja e efikasitetit dhe besueshmërisë të sistemit të Prokurimit Publik, duke miratuar Standardet e të Dhënave të Hapura të Kontraktimit (Open Contracting Data Standards) në proceset e prokurimeve, duke eliminuar “përrjashtimet e veçanta” nga prokurimi i fondeve publike dhe duke ju dhënë gazetarëve dhe shoqërisë civile më shumë akses në dosjet dhe të dhënat mbi procesin e prokurimeve.
4. Krijimi i një procesi efektiv Konsultimi Publik, duke ngritur mekanizma zbatimi në legjislacionin ekzistues dhe duke përfshirë në këtë proces edhe Vendimet e Këshillit të Ministrave. Procesi duhet të sigurojë transparencë dhe përfshirje të qytetarëve si edhe të grupeve të interesit.
5. Modernizimi i Sistemit të Taksave për t’u përputhur me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit (IFRS), për të reduktuar paqëndrueshmërinë me anë të prezantimit të ligjeve të reja tatimore jo më shpesh se çdo 4 vjet dhe luftës kundër informalitetit në ekonomi. Kjo do të krijojë një regjim taksimi më të parashikueshëm dhe më të qëndrueshëm, për të tërhequr investimet e huaja dhe ato vendase.

Duke Ju uruar edhe një herë suksese në punën Tuaj.

Me konsideratë,

Drejtor Ekzekutiv

Bledar Mankollari

